

Nikollë Shabani, MA¹

UDC:
343(496.5)

**LEGJISLACIONI PENAL NË TERRITORET SHQIPTARE DHE
NDIKIMI I TIJ NË POLITIKËN KRIMINALE GJATË HARTIMIT
TË STRATEGJISË NACIONALE**

**КАЗНЕНОТО ЗАКОНОДАВСТВО ВО АЛБАНСКИТЕ
ТЕРИТОРИИ И НЕГОВОТО ВЛИЈАНИЕ ВО КАЗНЕНАТА
ПОЛИТИКА ПРИ СОСТАВУВАЊЕ НА НАЦИОНАЛНАТА
СТРАТЕГИЈА**

**PENAL LEGISLATION IN ALBANIAN TERRITORIES AND ITS
IMPACT ON CRIMINAL POLICY NEED FOR A NATIONAL
STRATEGY**

Abstract

The subject of scientific research of this paper is the legal and scientific treatment in different views and international experiences regarding the murders; the etiology, characteristics, motives and forms of committing criminal offenses against life. For further study reasons and the importance of this phenomenon throughout Albanian territories Republic of Albania, Republic of Kosovo and Macedonia as well as other international scientific points of view. Criminal offenses against life have always been present and exposed in every society, which consistently has promoted scientific discussions about the prohibition and sanctioning of criminal offenses against life. In accordance with the standards and study space with special attention we have included all

¹ Doctorate at the Faculty of Law - Tirana, 2017

the arguments for and against the fierce punishments of criminal offenses - murder. Seeing in this prism, we have also relied on some theories and special views of the development of human psychics to decide on such an act of action that leaves space to be discussed and studied in many extended areas under contemporary living conditions that we have precisely defined some of the juridical-criminal views of Republic of Albania, Republic of Kosovo and Macedonia and other international scientific points of view.

Key words: Legal treatment, murders, etiology, coercion, motives, and forms Committing criminal acts against life in Albanian territories Republic of Albania Republic of Kosovo and Macedonia.

1. Çështjet mbi vdekjen ecin paralelisht me çështjet mbi jetën

Vdekja është fakt jetësor, juridik dhe nuk paraqet asgjë më shumë se sa fundi i jetës. Megjithëse njerëzit e provojnë vdekjen vetëm kur vdesin, ata përsëri kanë frikë të ballafaqohen me të, madje është frika më e madhe e njeriut. Është kjo arsyeja që çdo shtet e mbron me ligj jetën. Trevat autoktone mbarëkombëtare shtrihen sot, përveç nën administrimin e dy Qeverive të veta kombëtare, të Shqipërisë dhe Kosovës, po ashtu edhe në territoret e veta autoktone në shtetet fqinje të Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë dhe Greqisë. Në një sasi të shumë Revistave të ndryshme, punimeve me përmbajtje të hulumtimeve shkencore nga autor shqiptar, ende nuk kemi vërejtur një hulumtim shkencor, i cili jep indikacione unike të një veprimi unik legjislativ mbarëkombëtar, i cili mund të ndërlidhet si një strategji kombëtare konform Politikës Penale. Në hulumtime të juristëve shqiptarë vërejmë elaborime përkatëse, me elemente të cilat sjellin rezultate në politikën penale kombëtare shqiptare, edhe pse kodet penale në shtetet e trevave autoktone shqiptare evauluan në procese parimisht dhe ligjërisht të cilëve sot mund t'i bëjmë një ndarje në evaulimin e tyre deri në vitet 1990 dhe pas vitit 1990. Në vitet kur BE-ja fillon dukshëm në praktikë të shpalos platformën e vetë për Unionin e shteteve evropiane si me marrëveshjen e Shengenit I. 1990 dhe II. 1995, III. 2005 marrëveshja e Dublinit, e cila hyri ne fuqi 1997, Mastrihit 1992, Amsterdami 1997. Shqipëria dhe shqiptarët hynë në një proces të recesionit duke dal nga një sistem shoqëror komunist në një rregullim pluralist.²

² Gjysma e më tepër e shqiptarëve si nga aspekti i tyre autokton territorial, po ashtu edhe numri i popullsisë jetuan nën bashkësinë federative të shtetit Jugosllav, të ndarë

2. Veprat penale janë një çështje me rëndësi publike prandaj shoqëria i kundërvihet kriminalitetit

Parë në këtë prizëm, veprat penale janë një çështje me rëndësi publike, shoqëria i kundërvihet kriminalitetit, me që kriminaliteti rrezikon rendin juridik dhe social, kushtet elementare të jetës së përbashkët, vlerave themelore të njeriut dhe shoqërisë. Veprat me të cilat cenohet, dëmtohet apo asgjësohet vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar, në të drejtën penale quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. E drejta penale është një ndër mënyrat dhe mjetet me të cilat mbrohet shoqëria dhe luftohet kriminaliteti. E drejta penale e ushtron mbrojtjen nga kriminaliteti duke përcaktuar me ligj se cilat vepra apo sjellje të rrezikshme konsiderohen vepra penale dhe të cilat lloje të dënimeve apo të sanksioneve të tjera penale mund t'u shqiptohet kryesve të veprave penale. Me termin e drejta penale nënkuptojmë një degë të legjislacionit pozitiv të shtetit të caktuar dhe një degë të shkencave juridike, përkatësisht të shkencës së të drejtës penale. Si degë e legjislacionit pozitiv, e drejta penale është sistem i normave ligjore me të cilat përcaktohet se cilat vepra të njerëzve konsiderohen vepra penale dhe far lloje të dënimeve apo të sanksioneve penale do t'u shqiptohen kryesve të tyre. Me nocionin e këtillë përcaktohet vetëm kuptim formal, ngase ceken vetëm elementet apo tiparet formale- juridike të së drejtës penale.³Në kuptimin material e drejta penale

atë kohë në tri Republika Mal i Zi, Serbi, Maqedoni dhe në një Krahine autonome-Kosovë të cilët nga shteti në të cilin jetonin vlerësoheshin si irredentistë dhe ishin në shënjestër të parët për t'u nënshtruar torturës të kësaj bashkësie joorganike të shtetit Jugosllav, çfarë u dëshmuar edhe me luftën e shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni dhe në Kosovë Lindore Preshevë, Bujanovc, Medvegjë etj. si dhe në Mal të Zi me aksionin i quajtur "Fluturimi i Shqiponjave". Derisa shteti amë i shqiptarëve-Shqipëria, i shtyrë në një sistem ateist-komunist po ashtu joorganik për vetitë e veta kombëtare, pësoi një deformim identiteti dhe autoktonie personale e cila shoqërinë e këtij vendi e gjeti total jo të gatshme për shtegtimin e përgatitur për në Unionin e ardhshëm evropian, edhe pse shqiptarët ndër shekuj dhanë kontribute historike për vizionet në të cilën sot po bazohet BE, çfarë shqiptarët i veçon nga tërë popujt e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë.

³ Shqiptarët me politikën penale brenda territorit të vetë fillojnë të ballafaqohen të ndarë në pjesën e parë të shek. 20. Ato të cilët mbetën brenda shtetit amë, filluan të ballafaqohen me atë se si t'i nënshtrohen politikës penale, e cila mbas shumë viteve robëri duhet të krijoj respektin e duhur autoritar të shtetit për shqiptarët dhe kjo shpesh del me të mbeta praktike, si në kohën e Mbretërisë Zogiste si dhe me vone të asaj shtetësi shqiptare komuniste. Derisa shqiptarët nën ish Jugosllavi dhe Greqi, edhe pse brenda trevave të tyre autoktone u detyruan ti nënshtrohen një politike penale të popujve të tjerë, ku shpesh interesat e tyre nuk ishin të përfaqësuara drejtësisht. Me

kufizohet duke pasur parasysh veprat penale, qëllimin dhe funksionin e kësaj dege. Së këndejmi e drejta penale në kuptimin material përkufizohet si degë e drejtësisë me të cilën mbrohen nga veprat penale marrëdhëniet e caktuara të shoqërisë, të mirat juridike që i përkasin shoqërisë dhe individit. Duke i gërshetuar elementet e kuptimit formal dhe material, e drejta penale mund të përkufizohet si sistemi i normave juridike me të cilat, me qëllim të mbrojtjes të marrëdhënieve shoqërore, parashihen veprat penale dhe sanksionet penale që do t'u shqiptohen kryesve të veprave penale. E drejta penale e secilit vend është shprehje e atyre marrëdhënieve shoqërore që ekzistojnë në atë vend. Mirëpo përkundër dallimeve që ekzistojnë midis të drejtave penale të shteteve të caktuara, ekzistojnë edhe ngjashmëritë e konsiderueshme, sidomos lidhur me mbrojtjen e të mirave që i përkasin individit. Kështu për shembull vrasja plagosja, vjedhja, cenimi i nderit dhe autoritetit konsiderohen si vepra penale në të gjitha të drejtat penale bashkëkohore, pa marrë parasysh rregullimin shoqëroro-ekonomik që është i pranishëm në vendin përkatës. Si karakteristikë themelore e së drejtës penale është se kjo është e drejtë ligjore. Është ligjore meqë kjo degë e drejtësisë i rregullon çështjet nga lëmi i saj vetëm me ligj, e jo me ndonjë akt tjetër nënligjor apo norma tjera juridike. E drejta penale njeriun të drejta dhe liritë e tij si dhe sistemin e caktuar shoqëroro-politik e mbron duke paraparë dënime dhe sanksione tjera penale ndaj kryesve të veprave penale.⁴

3. Sanksionet penale dhe karakteri i dënimit

Sanksionet penale janë llojet më të rënda të sanksioneve të cilat zbatohen duke përdorur dhunën dhe me to, kryesve të veprave penale u kufizohet apo u merret liria, nderi, pasuria, të drejtat tjera, madje edhe

një ndarje të shqiptarëve nën imponim nga fuqitë e mëdha të kohës, si brenda shtetit Helen dhe në Mbretërinë e shteteve jugosllave dhe më vonë në transformimin federativ Jugosllav, popullata shqiptare u nënshtua një politike penale, e cila Ju impononte paraprakisht të mohojnë veten, t'i nënshtrohen një strategjie shtetërore, e cila është total joreale për të qenurit e saj.

⁴ Pasojat e një revolucioni të përshpejtuar nga një formacioni shoqëror në tjetrin, copëtimi i trojeve shqiptare me okupime nga kombësi të ndryshme kundër shqiptarëve, reflektuan me politika të ndryshme jo të drejta ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe në tërë këto periudha ndaj shqiptarëve, bëhet një politikë e padrejtë penale, si është ajo e një izolimi të padrejtë, robërisë dhe përçarjes të padrejtë, torturimit sipas kodeve dhe parimeve kushtetuese të padrejta, të cilat gjatë tere kohës në vete më tepër përmbajnë një politikë penale të padrejtë se sa të drejtë.

jeta në rasate kur shqiptohet dhe ekzekutohet dënimi me vdekje. Prej këtyre sanksioneve, dënimi është lloji më i rëndë i sanksioneve penale me të cilin përveç qortimit publik të shoqërisë për veprën e kryer, synohet që kryesi gjatë vuajtjes së dënimit të përmirësohet dhe të kthehet si anëtarë i dobishëm i shoqërisë. Ndërsa një ndër karakteristikat themelore e të drejtës penale është parimi i ligjshmërisë. Ky parim është garanci e progresit, humanizmit dhe demokracisë, nga se ky është njëkohësisht edhe një instrument i fortë për mbrojtjen e qytetarëve nga arbitrariteti eventual i shtetit. Shteti, përkatësisht gjykata mund ta thirrin në përgjegjësi penale qytetarin dhe mund t'i shqiptojnë sanksion të caktuar penal, vetëm nëse ai ka kryer ndonjë vepër e cila më par, me norma penale juridike është paraparë si vepër penale. Rëndësia dhe arsyeshmëria për studimin dhe hulumtimin e veprave penale kundër jetës në pikëpamje të gjurmimeve shkencore dhe aplikimeve në praktikë posaçërisht në një shoqëri në tranzicion dhe në kushte të një integrimi global, individi gjithmonë gjendet në sprova të ndryshme psikologjike, stresore dhe depresive që shpesh bien pre të këtyre situatave pa rrugëdalje dhe shpeshherë dhunën e drejtojnë nga të tjerët ose nga vetvetja siç janë suicidet. Prandaj, për rëndësinë dhe karakterin e këtij fenomeni jo aq të studiuar në aspektin praktikë dhe atë juridik me një koncept të përbashkët mbarë shqiptar do të kontribuojë në shkencën e së drejtës penale në hapësirat shqipfolëse për sa i përket fenomenit të vrasjeve dhe faktorëve që ndikojnë në një vendimarrje individuale drejtuar kundër jetës së njeriut. Hipoteza e përgjithshme trajton rëndësinë që ka hulumtimi shkencor për të përcaktuar çështjen që kanë të bëjnë me pikëpamjet juridiko-administrative dhe ato kushtetuese të vendeve përkatëse që parashohin legjislacionet e tyre në lidhje me fenomenin e vrasjeve dhe përmbushja meritore e të gjitha të drejtave, detyrimeve dhe sanksioneve që individi mund të kryej një veprim të kundërligjshëm siç është vrasja ose veprat penale kundër jetës në Shqipërisë, Kosovë dhe Maqedoni si dhe pikëpamje të tjera shkencore ndërkombëtare.

Panorama historike e lindjes të vrasjeve ose veprave penale kundër jetës dhe pikëpamjet në kuptimin burimor, përcakton kuptimin formën dhe metodën e kryerjes së veprave penale si veprime kriminogjene kundër jetës së njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi. Kuptimi vijues, është kujdesi pozitiv, angazhimi si dhe prevenimi nga këto vepra penale, sa është e mundur, të “jetohej” pa kanosje dhe rreziqe të tjera kundër jetës së njeriut duke e respektuar edhe jetën edhe ardhjen natyrore të

vdekjes. Kuptimi i tretë i veprave penale kundër jetës është bashkëkohor dhe krahas dy kuptimeve të para përfshinë edhe kuptimin „agresiv” marrjen e qëllimtë dhe të dhunshme të jetës së njeriut nga keqbërës në një shoqëri të caktuar siç është fjala për shoqërinë shqiptare. Forma rreptësisht formale është ajo që e dallon etiologjinë e fenomenit të vrasjeve deri tek një përfundim negativ i faktorëve dhe fenomeneve të tjera që ndikojnë në këtë prizëm. Mundësitë për një veprim preventiv të në luftimin e këtij fenomeni që mbron shoqërinë nga këto vepra penale kundër jetës si formë e veçantë dhe si qasje më serioze ndaj këtij problemi pikërisht në hapësirat shqiptare. Veprat penale kundër jetës në të përcillen në dritën e instrumenteve juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rrethanave të tjera dhe masat që duhet të ndërmerren nga organet përkatëse shtetërore. Aktet juridike ndërkombëtare në fuqi pikërisht konventa evropiane e të drejtave të njeriut si mund të jenë funksionale.

Meqenëse ekziston mundësia që vdekja të shkaktohet nga mënyra e mjete të ndaluara, është në interesin e bashkësisë shoqërore që të hulumtojë shkaku dhe mënyrën e vdekjes së çdo njeriu. Pa marrë parasysh se vdekja e një personi është shkaktuar me qëllim apo pa dashje, ajo është pjesë përbërëse e shumë veprave penale. Prandaj është detyrë e policisë që të sqarojë veprat penale dhe ngjarjet që kanë për pasojë vdekjen e personit të caktuar. Nocioni i vdekjes shqyrtohet edhe në kuptimin biologjik. Vdekja mund të ndodhë menjëherë pas kryerjes së veprimit, por mund të ndodhë edhe më vonë, pas një kohë më të shkurtër ose më të gjatë. Ka raste që në literaturë të përcaktohet koha e saktë midis veprimit kriminal dhe vdekjes së personit. Me rastin e kalimit të kësaj kohe nuk bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes, por për ndonjë vepër tjetër penale. Në të Drejtën anglosaksone ky afat kohor zgjat 12 muaj.⁵ E drejta penale pozitive e konsideron këtë afat si kohë të kaluar midis kohës së veprimit të një personi tjetër dhe pasojës së shkaktuar nga ai veprim, në qoftë se ekziston lidhje shkakore midis veprimit dhe pasojës. Ndonëse shkaqet e dëmtimit të shëndetit *etiologjia* janë të njëjta, mënyra e dëmtimit *patogjeneza* mund të jetë e dylllojshme: e natyrshme dhe e dhunshme. Dëmtimi i dhunshëm i shëndetit, *laesio*

⁵ Law Dictionary anglez e definon vdekjen si “Vrasje të kundërligjshme të qenies njerëzore, nëse vdekja ndodh në afat prej një viti”. Organizata botërore e Shëndetësisë ka sugjeruar që për vdekje të dhunshme të caktohet një afat prej 30 ditësh prej momentit të lëndimeve e deri të vdekja.

valetudinis violenta, ekziston atëherë kur kjo bëhet, me qëllim ose pa qëllim, nga një person tjetër. Për ndonjë ngjarje që ka për pasojë vdekjen është jashtëzakonisht e rëndësishme të përcaktohet shkaku i vdekjes, prej të cilit varet shumë kualifikimi juridik i ngjarjes. Vdekja e padhunshme ose e natyrshme është vdekja për shkak të shuarjes së funksioneve vitale të organizmit, nga pleqëria ose sëmundja.

4. Cilësia e çdo sjelljeje njerëzore si devijuese nuk është e natyrshme, por determinim social

Bashkësia shoqërore përpiqet që me forcë ta imponojë respektimin e tyre, duke identifikuar shmangiet nga to si sjellje devijuese. Cilësia e çdo sjelljeje njerëzore si devijuese nuk është e natyrshme, por determinim social: asnjë sjellje njerëzore nuk është devijuese vetvetiu, por në relacion me normat e caktuara shoqërore. Nga këtu, nocioni për sjelljen devijuese nuk është deskriptiv, por nocion askriptiv. Ai nënkupton gjykim negativ të shoqërisë, sipas të cilit sjellja e tillë shmanget nga ndalesat ose urdhrat e caktuara gjithëpërfshirëse dhe paraqet shkak për reaksionin shoqëror për shkak të korigjimit të sjelljes së individit. Nocioni për normën sociale është i lidhur për nocionin e vlerës, të mirës ose interesit social, ku në kuptimin më të gjerë nënkuptohet njeriu dhe vlerat dhe të mirat e tij si dhe funksionet e përbashkëta të jetës nëpër të cilat ai i realizon nevojat dhe interesat e veta individuale. Siç është norma e lidhur me nocionin për vlerën, ashtu edhe nocioni për devijimin është i lidhur me shkeljen e së drejtës ose vlerës që qëndron pas asaj norme. Formë të sjelljes devijuese paraqesin sjelljet asociale dhe anti-sociale, të cilët dallohen nga devijimi i rëndomtë sipas gradës më të lartë të shkeljes së kërkesave dhe normave sociale, ose sipas shkeljes së vlerave më të rëndësishme ekzistenciale që e tangojnë vetë bazën e organizimit shoqëror.⁶ Sjellja asociale është formë e rëndë e devijimit,

⁶ Megjithëse njerëzit e provojnë vdekjen vetëm kur vdesin, ata përsëri kanë frikë të ballafaqohen me të, madje është frika më e madhe e njeriut. Është kjo arsyeja që çdo shtet e mbron me ligj jetën. Një nga mbrojtësit kryesorë të jetës është edhe drejtësia penale si zbatues i nevojave dhe interesave e përbashkëta në një shoqëri të caktuar bashkëkohore. Rregullat për sjelljen e anëtarëve në bashkësinë njerëzore janë supozimi themelor dhe kushti elementar për ekzistimin e saj. Rregullat e sjelljes varen nga karakteri i zhvillimit të shoqërisë. Natyra e tyre është e ndryshme, ashtu që sistemin normativ të shoqërisë e përbëjnë normat morale, zakonore, juridike, etj. Por, cila çdo rregull ka kuptim vetëm nëse shkelja e saj paraqet përjashtim, përkundër

kurse sjellja antisociale formë më e rëndë e shkeljes së vlerave dhe të mirave më të rëndësishme individuale dhe shoqërore. Shoqëria u kundërvihet në mënyra të ndryshme sjelljeve të tilla të individëve, për arsye se ato i shkatërrojnë vlerat themelore të saj dhe çojnë kah një çorganizim ose kah një anomi sociale. E zënë nga sëmundjet e tilla, ajo është e gjykuar në shpërbërjen e të gjitha vlerave të saj shpirtërore dhe materiale.

Për definimin juridik, kriminale janë sjelljet që janë të ndaluara me normat e së drejtës penale. Sjellja e njeriut pavarësisht nga karakteri i saj asocial, dëmi i tij për të tjerët ose shoqërinë në përgjithësi bëhet penalo-juridikisht relevant edhe atëherë kur është i ndaluar me Kodin penal dhe kur për sjellje të tillë është paraparë dënim apo sanksion tjetër. Bëhet fjalë për definim formal ose pozitiv-juridik të kriminalitetit. Ai, përkundër definimit sociologjik nuk përgjigjet në pyetjen: pse një sjellje llogaritet si kriminale? Bëhet ajo kriminale për arsye se është e shpallur si vepër penale ose është e shpallur si vepër penale për arsye se është kriminale? Por, definimi juridik për dallim nga ai sociologjik nuk përjashton hulumtimin e mëtejshëm të këtyre aspekteve. Si formë e mosrespektimit të normave sociale, kriminaliteti e ndjek bashkësinë njerëzore që nga fillimi i saj. Reaksioni i veprimit të palejuar çdoherë ka pasur karakterin e reaksionit të detyrueshëm ndaj kryesit të shkeljes, por format dhe instrumentet e tyre ndryshohen me zhvillimin e bashkësisë shoqërore. Në fillimet e hershme të shoqërisë njerëzore shoqëria primitive, ajo është mbështetur mbi solidaritetin shoqëror, pajtimin dhe mjetet kolektive të reaksionit të detyrueshëm. Me paraqitjen e shtetit dhe së drejtës, ndalesat, shkelja e së cilave paraqet krimi, në emër të shoqërisë i definon shteti, kurse zbatimi i detyrueshëm i tyre merr karakterin e detyrimit shtetëror. Krimi paraqitet si një fenomen i cili duhet të jetë i sfiduar me fortësi dhe vendosmëri “goditese”.⁷

pranimit të përgjithshëm dhe respektit. Meqë çdo rregull, e formësuar nëpër norma të caktuara e përjeton fatin të jetë e cenuar.

⁷ Raporti i politikës Penale dhe dogmatikes penale , Politika Penale dhe dogmatikes penale janë në një korrelacion: 1) Qëndrimet e vlefshme të Politikës penale dhe “rrethanat aktuale” luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e dogmatikes penale. 2) Doktrina Penale tërheq politikë penale në një përcaktim të veçantë dhe udhëzon drejtë një zbutjes së politikës penale ose udhëzon drejtë një zbatimi me anë të ndryshimit të legjislacionit. Raporti i Politikës Penale me Kriminologjinë: “Teoria e varësisë” - Disa lloje konkrete të shpjegimit krimnologjik të veprave penale, çojnë rregullisht në veçantitë konkrete të reagimit në politikën penale. E kundërta është kërkimi konkret, Politika Penale kërkesën e vetë e realizon konform vetive të

Raporti i Politikës Penal me Politikën e Përgjithshme: Politika Penale në “Tregun” e politikës; Nëse e drejta Penale bëhet objekt i Politikës *politikën penale*, ka pasojë ballafaqimet e rivalitetit për çështje të pushtetit mes partive politike. Politika Penale duke pasur në njërin anë votuesin dhe në anën tjetër interesin e partive politike ajo duhet të posedoj në vete “vlera të këmbimit politik”. ata duhet të japin përshtypjen se programi i vet, për t'u marrë me luftimin e një problemi shoqëror me mjete penale, është në kontrollin e problemit më superior në programin e vet, sesa programet e partive tjera. ata duhet të mbjellin kompetencë dyshimi mbi partitë e tjera, nëse është e nevojshme deri në skandalim dhe përshkallëzim të ndikimit të mundshëm mbështetës të politikave tjera në Komunitet “kërcënime me kaos politik...”, “humbje sigurie...” . Fusha e politikës penale mund të shihet si një “treg” jetësor. Kërkesa e rritur për “sigurinë” rregullisht çon në një oferte edhe më të gjerë të zgjidhjeve represive. Zgjidhje represive rregullisht për ofruenin janë me kosto-efektive se sa zgjedhjet politika në struktura sociale dhe interesat ekonomike të korporatave me struktura politike.⁸ Nga parimet të cilët e ndihmuan Evropën Përendimore në nivelin avancimit të politikës penale në shoqëri dhe në institucione legjislative .⁹ Fushat kryesore të Politikës Penale janë: Përcaktimi i detyrave dhe funksioni i sistemit të drejtësisë penale duke përfshirë udhëzimet përkatëse. Përpunimi dhe Implementimi i një modeli të rregullave të caktuar konkretisht për disa probleme sociale. Evolucionin e zbatimit praktik të modeleve rregullative. rishikimi kritik i “Zonave Penale” dhe në raste konkrete ose reduktimi ose zgjerimi.¹⁰

kriminologjise. Raporti i politikës kriminale me Mediat publike A është përfaqësimi i kriminit në media një produkt i Politikës Penale? (teoria pula dhe vezët) ose A është lajmi i raportuar për Krimin “nxitës” i politikës penale? Të gjeturat: Paraqitja e lajmit për krimin në media çon në përshtypjen e kudogjendur të kriminit në realitet, kështu kontribuon në rritjen e frikës nga krimi. Dramatizimi i kushtëzuar për krimin (veçanërisht në TV komerciale) shkakton një pamje të shtrembëruar të , Llojet e publikimit të kriminit dhe kriminelëve. Kriminaliteti bëhet kundërfaktik me dhunën dhe sulmi abuzohet.

⁸ Pasojë e veprës penale të vrasjes është vdekja e ndonjë personi, por vazhdimisht është e hapur çështja e definimit të vdekjes. Sipas disa autorëve, vdekja është dëmtimi i shëndetit, *laesio valetudinis*, ndërprerja e tërësishme e funksionit të trupit gjegjësisht të strukturës dhe funksionit të trupit dhe shpirtit.

⁹ Felix Dr. Herzog: Ju veçoj disa definicione për Politikën Kriminale-Penale nga produkti i hulumtimeve të shkencave juridike në Universitetin e Bremenit-Gjermani.

¹⁰ Definicioni i Politikës Penale: Politika Penale mund të përkufizohet si përfitim, zbatimi dhe rishikimi i konceptit të Rendit në sistemit të drejtësisë penale.

Për një moment të kujtojmë se sot në kohën kur politika penale e BE-së analizon Konceptin e paralajmëruar të një Manifesti të politikës penale evropiane me paralajmërimet nga fakte të ndryshme që nga viti 2009, thelbësisht të prezentuar në mars të vitit 2010 nga Komisioneri i Drejtësisë të BE-së zonja Viviane Reding, e cila njoftoi nevojën për një qasje ndaj politikës të së drejtës penale, ku në radhë të parë u elaborua mundësia e ndërprerjes ligjore, e cila i ndihmon kriminelit të shpëtoj nga dënimi, faktikisht se si duhet të ndalohej një kriminel t'i shpëtojnë përgjegjësisë ligjore, duke ikur në një shtet tjetër anëtar të BE-së, për të përfituar nga dallimet e drejtësisë ligjore, derisa legjislacioni në trevat shqiptare sot është në angazhim për të ndarë krimin nga shteti. Legjislacioni shqiptar sot në Shqipëri angazhohet se si brenda drejtësisë shqiptare të themeloj një Byro Kombëtare Hetimi, e cila krahas luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duhet të ndaj krimin nga shteti. Derisa legjislacioni shqiptar në Kosovë angazhohet se si brenda drejtësisë vetë të themeloj një Gjykatë Speciale-Gjykatë të Posaçme, e cila do të gjykoj disa individë të cilët nga produktiviteti i çlirimit të Kosovës sipas ndërkombëtarëve sot mbajnë peng përparimin e vendit duke rrezikuar mbarësinë e vendit. Këto dy sfida aktuale në legjislacionet të dy shteteve shqiptare derisa mos të flasim për sfidat e shumta të legjislacioneve të shqiptarëve në Mal të Zi, Serbi, Maqedoni dhe Greqi të cilat janë në paradoks rrënjësor të dy shteteve të veta amë bëjnë të qartë se sa është e nevojshëm që rrethanat aktuale, të cilat politikën penale e karakterizojnë në një nevojë urgjente të hulumtimeve të nevojshme shkencore për një produktivitet konform nevojave vendore, regionale dhe më gjerë.

Strategjinë e bashkimit kombëtar brenda bashkimit evropian praktikisht mund ta avancojnë punimet hulumtuese shkencore në lëminë e legjislacionit, konform të gjitha vetive të veta nga legjislacionet e trevave autoktone në Ballkanin Perëndimor. Kujtojmë fjalimin e Kryeministrit shqiptar E. Rama në Ulqin 04.04.2015 "...Bashkimi i shqiptarëve do bëhet brenda Bashkimit Evropian...", qëndrim i cili i mërzi ato fqinjë të shqiptarëve, të cilët përherë bënë përpjekje të aplikojnë një politikë penale të njëanshme ndaj shqiptarëve, nga ky vështrim mund të përfundojmë që një hulumtim i drejtësisë shqiptare, konform drejtësisë ligjore e cila mund të dal nga politika penale mund të ndihmoj-avancoj edhe bashkimin e shqiptarëve. Në potencialin

intelektual shqiptarëve nuk i mungojnë kuadrat, por mos të harrojmë asnjëherë faktorët e trysnisë të cilat janë produkte të hidhura të padrejtës ndaj popullit tonë ku më së paku janë fajtorë shqiptarët, me këtë parim primarë nëse i qasemi perfeksionimit legjislativ të drejtësisë shqiptare mund të arrijmë rezultatet e kërkuara nga ne konform strategjisë të politikës penale të kritereve me parametra mbarë evropiane. Ja vlen të elaborohet shkencërisht ligji i një politike kriminale shtetërore ndaj shqiptarëve, si nga veçantit e të padrejtës grupore deri tek ato individuale elemente të cilat i hasim tek fqinjët tanë edhe sot në shtetet e Ballkanit Perëndimor gjatë rrugëtimit të tyre në një shoqëri demokratike bashkëkohore për në BE. Shqiptarët arritën ratifikimin e suksesshëm të shumë ligjeve bashkëkohore të cilat vlejné konform me politikën penale evropiane dhe botërore duke u profilizuar në angazhimin konform shumë organizmave dhe subjekteve organizative në afirmimin pozitiv të jetësimit të mbarësisë në vete drejtësinë e shqiptarëve në shtetin ligjor si p.sh.: Ligji për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë, Ligji për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë, Ligji për Policinë e shtetit (Ligji i ri 2014-Ligji i ri, njehsohet grada me funksionin, ndryshon paga e policëve), etj.

Conclusion

Today the shortcomings, not the proper achievements in the equality of the individual in the Albanian society and the lack of proper protection of the human factor from organized crime resulted with another devastating phenomenon, displacement or exodus of the 21st century within Europe. The Albanian exodus, who gave a public lecture as the failure of both Albanian and European politics, and has now started give the first positive products as it is a memorandum signed between the German and Kosovo Governments, which states that all those who know German and are over the age of 18 can compete for a specialization in Germany, which will last 3-5 years and these Cadres will be trained as specialists to work on the profitable productivity of future investor companies in the country. What is missing is such a possibility to be offered to women in Albania with a future Memorandum, this can significantly contribute to the Albanian society, to understand the contemporary principles more convincingly conform the features of criminal policy, starting from the first grades of education in society-family, to general legislation within a nation-state.

Reports of the abovementioned criminal policy we encounter and in everyday practice in our society, in the hope that from the past and present we can get the right indicators to contribute to the perfection of criminal policy throughout the Albanian territories, we encourage further researches. Disintegration and the economic crisis often favor organized crime, but national intelligence with relevant - adequate laws should interrupt any form of this negative insight in society, yet remains to be researched and perfected, but also the success achieved under extremely difficult inadequate circumstances for productive action, promises that we as a Albanian society are in the right direction. The legal solution of this matter has not been settled satisfactorily. Therefore, the definition of death today is a very current problem in judicial and clinical medicine as well as in justice. Today dominates the view that the legal definition of death is neither desirable nor necessary. The solution should be sought within the science of medicine and medical ethics.

BIBLIOGRAFIA

1. Altin Dr. Shegani “*E drejtë panel e krahasuar*” Tiranë, 2002
2. Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi “Sistemet e sigurisë-sisteme security” “Furkan-ISM “ Shkup, 2016
3. Bashkim Dr. Selmani “*Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi ndërkombëtar*” Botues: Universiteti parë privat “FON”- Shkup, 2008.
4. Afrim Dr. Osmani “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime” Shkup, 2010.
5. Jean Pradel & Geert Corstens & Gert Vermeulen “*E drejta penale Evropiane*” Dalloz, 2009.
6. Criminal justice system in Europe, *Evropian Institute for Crime prevention and Control* (United Nations)
7. Vesel Dr. Latifi “*Kriminalistika*” Prishtinë, 2011.
8. Ragip Dr. Halili “*Viktimologjia*” Prishtinë, 2011.
9. Ragip Dr. Halili “*Kriminologji*” Prishtinë, 2008.
10. Ergyn Qapan “*Një vështrim Islam mbi terrorizmin dhe sulmet vetëvrasëse*” Tiranë 2004.
11. Ismet Dr. Elezi & Vasilika Hysi “*Politika Kriminale*” Tiranë, 2001.

12. Rexhep dr. Gashi “Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri” Tiranë, 2001.

I. KODET PENALE TË DISA SHTETEVE

- ✚ Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- ✚ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- ✚ Kodi penale i Republikës së Maqedonisë
- ✚ Kodi penal i Gjermanisë
- ✚ Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë